

VENDIM
Nr.740, datë 1.7.2009

PËR KOMPENSIMIN NË TË HOLLA TË SUBJEKTIT TË SHPRONËSUAR,
AMBASADA FRANCEZE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 14, pika 1 shkronja “d”, e 17, të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 12 të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin në të holla të subjektit të shpronësuar, ambasada franceze në Republikën e Shqipërisë, për sipërfaqen e njohur 557,75 (pesëqind e pesëdhjetë e shtatë presje shtatëdhjetë e pesë) m², në vlerën 17 332 500 (shtatëmbëdhjetë milionë e treqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë.

2. Vlera e parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit dhe t’i vihet në dispozicion Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronës, e cila të kryejë veprimet për kalimin e saj në njërën nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ambasadës franceze, në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me procedurat për zbatimin e Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Drejtësisë dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha